



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo unutrašnjih poslova - Ministry of Internal Affairs

Rishikimi i Planit të Veprimit për Strategjinë e Reformës së Administratës Publike

Përshkrim i shkurtër i orientimit të reformave për tri vitet e ardhshme 2025-2027

Dhjetor, 2024

Përmbajtja

Hyrje	3
Progresi i deritanishëm: çështjet kryesore	3
Orientimi i reformave për periudhën 2025-27.....	5
1. Planifikimi dhe koordinimi i politikave	5
2. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve.....	6
3. Shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore	7
4. Llogaridhënia dhe transparenca në administratën publike.....	8
Ndërlidhja me Planin e rritjes	9
Aspekte të monitorimit dhe raportimit	Erreur ! Signet non défini.

Hyrje

Ky dokument paraqet një përshkrim të rishikimit të Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Reformën e Administratës Publike 2022-2027. Ministria e Punëve të Brendshme, nën kryesimin e Departamentit për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike dhe me bashkëkryesim të Zyrës së Kryeministrit, përkatësisht Zyrës për Planifikim Strategjik, ka iniciuar rishikimin e planit të veprimit, për të përfshirë periudhën e ardhshme tri vjeçare të planifikimit.

Në këtë kontekst, rishikimi i planit të veprimit është bazuar në progresin e zbatimit të aktiviteteve nga plani i veprimit 2022-24 dhe ka marr parasysh sfidat aktuale të identifikuara nga vet institucionet. Sa i përket, të parës një pjesë e aktiviteteve të cilat nuk janë zbatuar deri në nëntor 2024 janë bartur në planin e rishikuar. Kjo është bërë për të siguruar se reformat arrijnë synimet e parapara në Strategjinë për Reformën e Administratës Publike. Sa i përket, sfidave aktuale institucionet përgjegjëse kanë konsideruar rekomandimet të Raportit të Monitorimit të Administratës në Kosovë, në kuadër të vlerësimit të rregullt nga OECD/SIGMA kundrejt Parimeve të Administratës Publike.¹

Kjo përmbledhje e rishikimit të Planit të Veprimit, fillimisht paraqet progresin e deritanishëm në zbatimin e reformave për katër objektivat strategjike. Pastaj, përshkruan orientimin e reformave për secilën fushë, duke dhënë shpjegimet e nevojshme për ndryshimet eventuale, bartje të veprimeve nga PV 2022-24 apo nëse janë paraqitur aktivitete të reja. Këtu theksohet gjithashtu ndërlidhja ndërmjet Planit të Veprimit dhe dokumenteve të tjera strategjike. Seksioni i katërt, përshkruan në veçanti ndërlidhjen e Planit të Veprimit me Agjendën e Reformave në kuadër të Planit të Rritjes të dakorduar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Në fund, paraqiten aspektet kryesore sa i përket monitorimit dhe raportimit, në veçanti nëse ka ndonjë ndryshim në kuadër të treguesve të Strategjisë.

Progresi i deritanishëm: çështjet kryesore

Nga gjithsej 142 masa reformuese të planifikuara për zbatim, 71 aktivitete 50% kanë arritur të zbatohen me sukses. Në lidhje me treguesit, niveli i zbatimit të treguesve është tejte i ulët, nga 39 tregues vetëm 5 tregues janë arritur ose 7.8%, ndërsa 34 tregues tjerë janë nën zbatim ose janë në zbatim e sipër.

Sa i përket **planifikimit dhe koordinimit të politikave**, nga 50 aktivitete, 26 aktivitete janë zbatuar, apo 52%. Storie suksesi ka qenë miratimi i Planit Kombëtar për Zhvillim me ç' rast është bërë definimi i 16 sektorëve të politikave publike dhe e njëjta qasje është zbatuar në Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme në kuadër të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve. Po ashtu, është funksionalizuar edhe përbërja e trupave qeveritare

¹ <https://ëëë.sigmaëeb.org/publications/Public-administration-in-Kosovo-2024.pdf>

koordinuese për planifikim strategjik, si dhe është zhvilluar forma e planeve institucionale.

Ndër sfidat e vazhdueshme janë planifikimi i dobët, dhe mungesa e theksuar e bashkëpunimit dhe koordinimit të duhur ndërinstytucional, gjë që ka ndikuar veçanërisht në aftësinë e qeverisë për të vazhduar më tej në reformimin e administratës publike. Për më tepër, vlerësimi i funksionimit të strukturave koordinuese, ende është kompleks në përmbushjen e rolit të saj, dhe rezulton me mbivendosje dhe paqartësi.

Në drejtim të **përmirësimit të ofrimit të shërbimeve**: nga 27 aktivitete, janë zbatuar 10 aktivitete, apo 37%. Qeveria përmes ASHI/MPB ka dixhitalizuar me sukses dhe ka rritur në 195 numrin e shërbimeve të ofruara përmes platformës e-Kosova. Është hartuar metodologjia për harmonizimin e ligjeve të veçanta me LPPA-në, dhe është propozuar plani i harmonizimit i cili është zbatuar në 2 vite me radhë. Janë analizuar 81 Ligje të veçanta ku 37 ligje nuk kanë procedura administrative ose që janë në pajtim me LPPA, 38 ligje të veçanta, dhe 6 ligje me propozime direkte në projektligje. Gjithashtu, është miratuar Manuali për Vlerësimin Ex-Post të Akteve Ligjore.

Sfidë e vazhdueshme që e ka përcjellë në vazhdimësi mbetet mungesa e kapaciteteve si në përgatitjen dhe hartimin e politikave, po ashtu edhe në zbatimin dhe monitorimin e shërbimeve publike. Pavarësisht rekomandimeve dhe zotimeve politike ende nuk është themeluar struktura përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve gjë që ndikon në planifikimi të dobët strategjik. Po ashtu, fragmentimi dhe ndërlidhja jo e qartë në mes të dokumenteve të tjera strategjike e ka karakterizuar këtë proces.

Sa i përket **shërbimit publik dhe menaxhimit të burimeve njerëzore**: nga 38 aktivitete, 20 aktivitete janë zbatuar, apo 53%. Në këtë drejtim, është bërë vlerësimi dhe zbatimi i akteve nënligjore aktuale që dalin nga LZP, si dhe ka vazhduar puna në drejtim të kompletimit të kornizës së tërësishme ligjore, dhe atë me hartimin dhe miratimin e katërbëdhjetë (14) akteve nënligjore. Është bërë përditësimi i katalogut të vendeve të punës dhe përshtatjes së tyre me ndryshimet e reja ligjore, si dhe standardizimi i përshkrimit të detyrave të punës.

Me qëllim të plotësimit të kornizës së legjislationit sekondar për zbatimin e Ligjit për Pagat për nëpunësit e sektorit publik, janë miratuar gjithsej dymbëdhjetë (12) akte nënligjore. Me këtë rast, është bërë kryerja e monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshme për zbatimin e ligjit për paga dhe akteve të tij nënligjore ku është bërë korrigjimi/përshtatja e të dhënave e të punësuarve në sektorin publik për pjesën dërmuese të pagave sipas kërkesave nga institucionet përkatëse. Përmes IKAP, janë organizuar mbi 14 kurse trajnimi duke përfshirë: hartimi dhe zbatimi i strategjive sektoriale; sistemi i menaxhimit të performancës dhe mbikëqyrja e agjencive, etj. Nga

këto kurse trajnimi janë trajnuar mbi 529 pjesëmarrës nga të gjitha institucionet duke përfshirë nivelin qendror dhe atë lokal.

Kapacitetet e mangëta në të gjithë sektorin publik, ngritja e kapaciteteve strukturore në DMZP mbetet ende problematikë e theksuar, dhe mbi të gjitha përfundimin e procesit të organizimit të brendshëm dhe sistematizimin institucional- gjë që ka ndikuar veçanërisht në aftësinë e qeverisë për të vazhduar më tej në reformimin e administratës publike.

Sa i përket **rritjes së nivelit të llogaridhënies dhe transparencës në administratën publike**: nga 27 aktivitete, 15 aktivitete janë zbatuar, apo 56%. Ka vazhduar puna në drejtim të përfundimit të procesit të racionalizimit të agjencive. Është miratuar Programi për Racionalizimin e Agjencive. Në këtë pikë është hartuar dhe miratuar Metodologjia për Përgatitjen e Propozimit për Krijimin, Bashkimin dhe Shuarjen e Agjencive. Po ashtu, është miratuar edhe rregullorja për sistemin e menaxhimit të performancës së agjencive, si dhe është miratuar Udhëzuesi për Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë. Në zbatim të rregullores dhe udhëzuesit deri me tani janë hartuar dhe miratuar njëzetënjë (21) Plane të Performancës të Agjencive Ekzekutive dhe Rregullatore.

Po ashtu, është bërë analiza e inspektimeve e bazuar në rrezik, duke hartuar Udhëzuesin për Njoftimin e Inspektimit; Udhëzuesin për Miratimin e Inspektimit; dhe Udhëzuesi për Inspektimin e Bazuar në Rrezik. Në drejtim të qasjes në informacionin publik, AIP në cilësinë e organit mbikëqyrës ka mbledhur dhe hartuar raportin vjetor për qasje në kërkesat publike të pranuar dhe trajtuara nga secili institucion. Nga 159 institucione publike, numri i përgjithshëm i kërkesave për qasje në dokumente publike në nivel vendi rezultoi në 4,465.

Përfundimi i organizimit të brendshëm dhe sistematizimit të vendeve të punës si proces i papërfunduar paraqet sfidë edhe në zbatimin e ligjit të pagave. Njëherit, mungesa e zbatimit të duhur të LOFASHAP, procesi i ngadaltë i racionalizimit dhe krijimit të agjencive të reja, mbetet ende sfidë.

Orientimi i reformave për periudhën 2025-27

1. Planifikimi dhe koordinimi i politikave

Në kuadër të Objektivës Strategjike **“Planifikimi dhe koordinimi i politikave i orientuar drejt rezultateve”**, në kuadër të planit të rishikuar ka një vazhdimësi të reformave që kanë për qëllim krijimin e një sistemi planifikimi dhe koordinimi më efikas, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në qeverisje, si dhe zhvillimin e politikave që

janë të bazuara në të dhëna, duke forcuar kështu kapacitetet institucionale dhe rritjen e performancës.

Nuk ka ndonjë ndryshim domethënës në nivel të treguesve përpos faktit që treguesit e SIGMA do të maten nga vet institucionet për shkak të ndryshimit të metodologjisë. Një ndryshim rreth caqeve në treguesit e objektivës specifike 2 mund të bëhet për të reflektuar më mirë gjendjen aktuale, por kjo do të përmirësohet më mirë gjatë raportimit të ndërmjetëm treguesit e ndikimit dhe rezultatit.

Sa i përket objektivave specifike orientimi i reformave në tri vitet e ardhshme fokusohet në aspektet në vijim:

Objektiva specifike 1: Sistem efektiv dhe i integruar i planifikimit të politikave – Në kuadër të kësaj objektivë fokusi kryesor i reformave është në plotësimin e kornizës rregullative, përkatësisht rishikimin e Rregullores së Punës së Qeverisë të cilës i paraprinë një vlerësim mbi zbatimin e saj dhe identifikimin e çështjeve kryesore për rishikim. Kjo do të plotësohet paralelisht me rishikimin e manualeve për planifikim dhe monitorim të politikave si dhe strukturave përgjegjëse për planifikim strategjik. Veprimi i ri dhe me rëndësi gjatë kësaj periudhe është vlerësimi i ndërmjetëm i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe rishikimi i saj për të në nivel të qëllimeve zhvillimore dhe strategjike.

Objektivi Specifik 2: Rritja e performancës institucionale, transparencës dhe llogaridhënies – në kuadër të kësaj objektivë aktiviteti më i rëndësishëm dhe që bartet nga PV 2022-24, është zhvillimi i sistemit elektronik për planifikim dhe raportim. Për shkak të vonësave në fillimin e projektit që do të mbështesë këtë proces ky aktivitet bartet për periudhën e ardhshme. Në anën tjetër do të vazhdohet me pilotimin e planeve institucionale dhe fillimin e aplikimit të tyre në të gjitha ministritë. Për fund, si aktivitete të reja janë paraparë zhvillimi i manualit për konsultime publike, avancimi i platformës për konsultime dhe trajnimet për përdorimin e saj.

Objektivi Specifik 3: Zhvillimi i politikave duke u bazuar në të dhëna dhe ngritja e kapaciteteve – reformat fokusohen në zhvillimin e metodologjive për prioritizimin e politikave dhe mbajtja e trajnimeve për hartim të legjislacionit. Gjithashtu, këtu parashihet dhe finalizimi i udhëzimeve për harmonizim me acquis dhe trajnimet përkatëse në këtë drejtim. Një aspekt i veçantë është avancimi i procesit të konsolidimit të legjislacionit përmes zhvillimit të planeve për konsolidim, vendosjes së platformës elektronike dhe të tjera. Aktivitete të reja janë paraparë në lidhje me zhvillimin e metodologjisë për analizën e zbatimit të ligjeve.

2. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve

Në kuadër të Objektivit për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ka një vazhdimësi të reformave nga plani i kaluar, në kuadër të të cilave parashihet koordinimi,

rregullimi më i mirë dhe harmonizimi me dokumentet tjera strategjike relevante, siç është Strategjia për Qeverisje Elektronike 2023-2027 dhe Programi për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2025-2028.

Në kuadër të këtij planit të veprimit fokusin kryesor e merr harmonizimi i ligjeve të veçanta me LPPA, si dhe identifikimi, harmonizimi dhe mbikëqyrja e të gjitha akteve nënligjore për harmonizim me LPPA. Ndër të tjera, fokus merr edhe koordinimi ndër institucional për ofrimin e shërbimeve, si dhe koordinimi dhe bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile.

Ndër të tjera, në kuadër të rritjes së cilësisë së shërbimeve parashihen zhvillimi i mjeteve të ndryshme që përdoren nga administrata, në mënyrë që cilësia e shërbimeve të rritet, si dhe përmban mjete të tjera për ndihmë të vazhdueshme për përdoruesit që përdorin platformën e-Kosova. Rritja e numrit të shërbimeve në eKosova është një nga aspektet kyçe të reformës në këtë fushë.

3. Shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore

Ky objektivi fokusohet në forcimin e kapaciteteve të administratës publike për të siguruar një shërbim publik më të profesionalizuar dhe një menaxhim më efikas të burimeve njerëzore. Aktivitetet për periudhën 2025-2027 synojnë përmirësimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe përmirësimin e kapaciteteve të institucioneve shtetërore për të rekrutuar dhe menaxhuar burimet njerëzore në mënyrë efikase dhe të centralizuar.

Sa i përket objektivave specifike orientimi i reformave në tri vitet e ardhshme fokusohet në aspektet në vijim:

Objektivi specifik 1: Korniza ligjore dhe institucionale për shërbimin civil është përmirësua - Një aktivitet kryesor është zhvillimi dhe përmirësimi i procedurës së centralizuar të rekrutimit për të siguruar një proces më të drejtë dhe më transparent të përzgjedhjes së nëpunësve civilë. Për këtë qëllim, do të organizohen trajnime për stafin e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (DMZP) për të menaxhuar më mirë proceset e rekrutimit dhe seleksionimit. Po ashtu, do të plotësohen pozitat e lira në këtë departament dhe në Nivelin Qendror të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (NJMBNJ). Gjithashtu, është përfshirë krijimi i bazës ligjore që do të mundësojë ndërlidhjen e sistemeve të menaxhimit të burimeve njerëzore përmes miratimit të rregullores për administrimin e Sistemit të Informacionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ),

Objektivi Specifik 2: Shërbimi publik aplikon parimet e profesionalizmit, meritokracisë, efikasitetit dhe mundësive të barabarta - në kuadër të kësaj objektivie një aktivitet me rendësi është standardizimi i përshkrimeve të detyrave të punës për të siguruar përputhshmërinë me ndryshimet ligjore. Po ashtu, është planifikuar zhvillimi i një banke

pyetjesh për shërbimin civil, si dhe nënshkrimi i memorandumeve bashkëpunimi me institucione të tjera, si Komisioni i Pavarur i Shërbimit Civil të Kosovës (KPMSHCK), për të ndarë të dhëna dhe për të siguruar transparencën në proceset e rekrutimit. Aktivitet tjetër me rëndësi është edhe trajnimi i anëtarëve të komisioneve të pranimit për zbatimin e procedurave të rekrutimit.

Objektivi Specifik 3: Sistem i drejtë, transparent dhe i barabartë për pagat është krijuar dhe zbatohet në praktikë - Për të siguruar implementimin e sistemit për menaxhimin e performancës do të bëhet ristrukturimi dhe sistematizimi i vendeve të punës të ministrive, si dhe përmirësimi i mëtejshëm i SIMBNJ duke mundësuar ndërveprimin më të avancuar me sistemin e pagave. Kjo do të mundësojë një menaxhim të avancuar dhe të integruar të burimeve njerëzore, duke siguruar që të dhënat mbi pagat dhe menaxhimin e burimeve njerëzore të jenë në një sistem të integruar dhe transparent.

Objektivi Specifik 4: Sistemit i zhvillimit profesional të nëpunësve civilë është përmirësuar dhe funksionon - Për të garantuar një përmirësim të vazhdueshëm të kapaciteteve të administratës publike, aktivitetet parashikojnë zhvillimin e moduleve të trajnimit të detyrueshëm për të gjitha kategoritë e administratës publike, si dhe analizën e financimit të trajnimeve për të siguruar që investimet në zhvillimin e burimeve njerëzore të jenë të qëndrueshme dhe efikase.

4. Llogaridhënia dhe transparenca në administratën publike

Ky objektivi fokusohet në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në institucionet publike, duke përmirësuar proceset e menaxhimit të informacionit dhe rritjen e aksesit të qytetarëve në të dhëna dhe shërbime publike. Aktivitetet për periudhën 2025-2027 përfshijnë një sërë masash për të avancuar transparencën dhe llogaridhënien, duke siguruar që informacioni i rëndësishëm të jetë në dispozicion të qytetarëve dhe që proceset e administratës shtetërore të jenë të hapura dhe të mbikëqyrura.

Orientimi i reformave për objektivat specifike në tri vitet e ardhshme fokusohet në aspektet në vijim:

Objektivi Specifik 1: Përmirësimi i organizimit të administratës shtetërore me vija të qarta të llogaridhënies brenda dhe në mes të institucioneve - Një aktivitet i rëndësishëm është miratimi dhe zbatimi i rregulloreve për organizimin e brendshëm të institucioneve dhe agjencive të pavarura në përputhje me Ligjin për Organizimin e Administratës Shtetërore dhe Administratën Publike (LOFASHAP), i cili do të sigurojë që institucionet do të funksionojnë në përputhje me praktikën më të mira dhe kërkesat ligjore për transparencë dhe llogaridhënie. Po ashtu, do të hartohet dhe miratohet legjislacioni për racionalizimin e agjencive të ndryshme, duke mundësuar një administratë më të përqendruar dhe më efikase. Ky proces do të monitorohet dhe përcillet nga një sistem i

avancuar për menaxhimin e performancës, i cili do të sigurojë që agjencitë dhe institucionet të mbajnë përgjegjësi për rezultatet e punës së tyre.

Objektivi Specifik 2: Rritja e qasjes në dokumente publike nga qytetarët dhe bizneset në nivel qendror dhe lokal - Në përpjekje për të rritur transparencën, do të zbatohet programi i transparencës për promovimin e së drejtës për qasje në dokumente publike dhe do të rritet publikimi proaktiv i dokumenteve nga institucionet publike. Kjo do të mundësojë që qytetarët të kenë akses më të madh në informacion dhe të mund të mbikëqyrin aktivitetet e administratës shtetërore. Një tjetër aktivitet i rëndësishëm është digjitalizimi i të gjitha shërbimeve të ofruara nga Agjencia për Informim dhe Privatësi, që do të kontribuojë në ofrimin e shërbimeve më të shpejta, më të sakta dhe më të aksesueshme për qytetarët. Kjo gjithashtu do të përmirësojë mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë në administratën publike.

Objektivi Specifik 3: Rritja e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura nga institucionet në nivel qendror dhe lokal - aktivitetet që do të vijojnë të zbatohen në kuadër të kësaj objektivë specifike përfshijnë përgatitjen e planeve për informimin, konsultimin dhe koordinimin me institucionet përkatëse, përditësimin dhe mirëmbajtjen e matricës së monitorimit për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, si dhe organizimin e tryezës vjetore në bashkëpunim me Qeverinë, Avokatin e Popullit dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit. Këto aktivitete kanë si qëllim sigurimin e një procesi të strukturuar dhe të koordinuar për monitorimin dhe implementimin efektiv të rekomandimeve, duke rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë e institucioneve përkatëse

Ndërlidhja me Planin e rritjes

Ndërlidhja e PV SRAP 2025-2027, me dokumentet tjera strategjike për fushën e AP është paraparë në një kaskadë objektivash strategjik përmes treguesve dhe caqeve të matshme përfundimtare për vitin e fundit 2027. Ndër të tjera ndërlidhja e PV SRAP 2025-2027, është bërë dhe është reflektuar me masa konkrete reformuese edhe me Agjendën e Reformave (planin e rritjes). AR, përmban gjithsej 5 fusha të politikave, 18 nën fusha, 30 reforma dhe 109 hapa të reformave. Bazuar në këtë strukturë të AR, Plani i Punës për zbatimin e saj është i strukturuar siç përshkruhet në plan. Fushat dhe nën fushat e politikave: 1. Qeverisja, reforma e administratës publike (RAP) dhe menaxhimi i financave publike (MFP), me dy 2 nën fusha, 4 reforma dhe 15 hapa reformash, si në vijim: 1.2. Reforma e administratës publike, dhe 1.3. Menaxhimi i financave publik. Reformat janë objektiva afatmesme që synohet të arrihen në secilën prej nën fushave deri në fund të periudhës së zbatimit të këtij dokumenti. AR përmban gjithsej 30 reforma, të shpërndara në fusha të politikave siç është përshkruar më sipër. Reformat janë të formuluar në mënyrë të gjerë, duke adresuar aspekte sistemike të avancimit të legjislacionit, politikave dhe funksionimit të institucioneve në drejtim të përafrimit me

legjislacionin, standardet dhe praktikat e BE-së. Plani i Punës si pjesë e AR dhe mekanizëm për zbatimin e saj, do të jetë në harmoni me Programin Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) dhe Planin Kombëtar për Zhvillim (PKZH), përfshirë Programin Legjislativ të Qeverisë (PLQ), rrjedhimisht edhe PV SRAP 2025-2027, është në ndërlidhje.

Për më tepër, PV SRAP 2025-2027 është i ndërlidhur me fushën e politikave **“Qeverisja, RAP dhe MFP”**, i zbërthyer më tej në komponentin/ sektorin **“Reforma e administratës publike”**, ndërkaq reformat e parapara ndër të tjera janë *“forcimi i kapacitetet administrative përmes plotësimit të rregullt të vendeve të lira të punës në administratën publike dhe përmes zvogëlimit të numrit të pozitive të lira të hapura dhe atyre me ushtrues detyre, duke përmirësuar në të njëjtën kohë menaxhimin dhe monitorimin e burimeve njerëzore bazuar në fakte”*, si dhe përmes *“vendosjes së një sistemi transparent kompensimi dhe organizim i thjeshtë i ministrive të linjës dhe organeve vartëse për një administratë llogaridhënëse”*. Këto janë pasqyruar qartazi në dy Objektivat Strategjike të SRAP 2022-2027 (Shërbimi Publik dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore; dhe Llogaridhënia dhe Transparenca), me tregues të matshëm, ku baza, dhe caqet kanë derivuar nga vet SRAP 2022-2027. Masat e reformave dhe hapat cilësorë ose sasiorë ë paraparë në AR, janë transpozuar edhe në PV SRAP 2025-2027, në dy fushat e lartpërmendura.

Aspekte të monitorimit dhe raportimit

Në kuadër të kapitullit të “Monitorimit, raportimit dhe vlerësimit” në SRAP 2022-27 është përcaktuar qartë korniza e monitorimit dhe raportimit. Si rrjedhojë, SRAP dhe Plani i tij i veprimit përfshinë tregues të performancës dhe nën-tregues në nivelin e rezultateve për të matur progresin dhe rezultatet e reformës. Treguesit në veçanti shpjegohen dhe përshkruhen në të ashtuquajturën “pasaporta e treguesve” që është aneks i strategjisë.

SRAP ka ndjekur hierarkinë e qëllimeve zhvillimore dhe strategjike të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim. Më konkretisht fushat prioritare të SRAP ndërlidhen me qëllimin strategjik të SKZH, si rrjedhojë Objektivat e përgjithshme të fushave prioritare të SRAP shoqërohen me tregues sasior/cilësorë të rezultateve dhe për këtë qëllim përdoren kryesisht tregues nga korniza e monitorimit të SIGMA-së. Duhet theksuar se Plani i rishikuar i veprimit 2025-27 nuk parasheh ndonjë ndryshim në nivel të treguesve apo vlerave të caqeve të përcaktuara në strategji. Edhe pse mund të ketë ndryshime sa i përket vlerave të caqeve, këto do të reflektohen në raportet vjetore të monitorimit në veçanti, raportin për vitin 2025 ku pritet të mblidhen të dhënat dhe të raportohet për arritjen e caqeve të ndërmjetëm.

Në kontekst të treguesve që përdoren nga Raportet e monitorimit të SIGMA, duhet të theksohet se tashmë SIGMA ka ndryshuar metodologjinë e vlerësimit. Si rrjedhojë, disa tregues kanë ndryshuar në kuptimin e definimit, e më kryesorja është ndryshuara

mënyra e kalkulimit të treguesve. Në një situatë të tillë, do të duhet të rishikoheshin edhe treguesit që nënkupton rishikim jo vetëm i planit të veprimit por edhe i strategjisë. Prandaj, është vendosur që të mbahen treguesit e SIGMA, mirëpo burimi i të dhënave të kaloje tek institucionet përgjegjëse të Kosovës duke përfshirë edhe matjen e tyre sipas metodologjisë së kaluar të kalkulimit. Sipas kësaj, për treguesit në vijim do të ndryshojë burimi i të dhënave do të ndryshojë nga “Raporti Monitorues i SIGMA” tek të dhënat administrative të institucioneve përkatëse:

- **Objektivi i Përgjithshëm I: Planifikimi dhe koordinimi i politikave i orientuar drejt rezultateve**
Treguesi 1: Cilësia e planifikimit të politikave.
Burimi i të dhënave: ZKM dhe MFPT
Treguesi 2: Përbushja e funksioneve kritike nga institucionet e Qendrës së Qeverisë
Burimi i të dhënave: ZKM, MPB, MFPT
- **Objektivi i Përgjithshëm II: Avancimi i shërbimeve të orientuara nga administrata publike**
Treguesi 1: Cilësia e ofrimit të shërbimeve
Burimi i të dhënave: MPB
- **Objektivi i Përgjithshëm III: Shërbim publik profesional dhe menaxhim efektiv i burimeve njerëzore**
Treguesi 1 Vlera mesatare e treguesit për fushën e shërbimit publik dhe menaxhimit të burimeve njerëzore
Burimi i të dhënave: MPB
- **Objektivi specifik 3.3: Sistem i drejtë, transparent dhe konkurrues për pagat është krijuar dhe zbatohet në praktikë**
Treguesi 1: Shkalla në të cilën korniza ligjor dhe sistemi i pagave në shërbim publik mbështesin pagesën dhe shpërblimin e drejtë dhe transparent të nëpunësve civilë
Burimi i të dhënave: MPB
- **Objektivi i Përgjithshëm IV: Rritja e nivelit të llogaridhënies dhe transparencës në administratën publike**
Treguesi 1: Llogaridhënia në administratën publike
Burimi i të dhënave: Ministria e Punëve të Brendshme

Sa i përket sekuencimit të grumbullimit të të dhënave do të ndjeket praktika e raportimit më gjithëpërfshirës për caqet e ndërmjetme, që do të mbulojë raportimin vjetor për vitin 2025, dhe mbledhje të të dhënave në përgjithësi për treguesit e mësipërm. Në anën tjetër,

siç është përcaktuar në kapitullin e “Monitorimit, raportimit dhe vlerësimit” do të ndërmerret një vlerësim përfundimtar i jashtëm i strategjisë.

Në të dy momentet e grumbullimit të të dhënave, do të merret parasysh ndryshimi i rrethanave sa i përket vlerave të caqeve që janë përcaktuar në strategji. Ka raste kur strategjia ka përcaktuar vlera më pak ambicioze të caqeve, të cilat janë tejkaluar më herët se sa caqet e ndërmjetme ose përfundimtare. Në disa raste, këto caqe duhet të përshtaten me caqet e dakorduara në kuadër të Planit të Rritjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian.

Draft-Plani i Veprimit 2025-2027 për zbatimin e Strategjisë për Reformën e Administratës Publike 2022-2027

Nr.	Objektivat e përgjithshëm dhe specifik, treguesit dhe veprimet	Vlera bazë	Synimi i përkohshëm (2025)	Synimi i vitit të fundit (2027)	Rezultati
PLANIFIKIMI DHE KOORDINIMI I POLITIKAVE					
I.	Objektivi i Përgjithshëm: Planifikimi dhe koordinimi i politikave i orientuar drejt rezultateve				
1	Treguesi: Cilësia e planifikimit të politikave Burimi: ZKM	2.52/5	>2.5/5	3/5	Mekanizmat institucional, infrastruktura ligjore, dhe procedurat administrative janë të themeluara për harmonizimin e planifikimit të politikave, si dhe kualitetin dhe ndërlidhjen e dokumenteve të planifikimit. Rezultatet e procesit të planifikimit dhe niveli adekuat i vlerësimit të ndikimit financiar të strategjive sektoriale.
2	Treguesi: Përbushja e funksioneve thelbësore nga institucionet e qendrës së Qeverisë Burimi: ZKM	4/5	4/5	5/5	Funksionet thelbësore të Qeverisë janë të mbuluara për një sistem konsistent dhe kompetent të politik bërjes.
I.1	Objektivi specifik 1: Sistem efektiv dhe i integruar i planifikimit të politikave				
1	Treguesi: % e strategjive sektoriale të miratuara me përmbajtje minimale. Burimi: ZPS-Raporti vjetor	80% 2024	85% 2025	95% 2027	Përmirësimi i përmbajtjes minimale në dokumentet strategjike të miratuara në Qeveri
Nr.	Veprimi		Buxheti		Produkti

		Afati i fundit	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	(Output)	Referenca në dokumente
1.1.1	Vlerësimi i aplikimit të Rregullores së Punës së Qeverisë dhe identifikimi i nevojave për ndryshim	TM4 2025	10.000,00			TBD	ZKM Donatorët	Vlerësimi i finalizuar dhe publikuar	N/A
1.1.2	Rishikimi i Rregullores së Punës së Qeverisë në bazë të gjetjeve të vlerësimit	TM2 2026		5,000.00		BK	ZKM	Kapitulli i planifikimit të politikave të ndryshuar	N/A
1.1.3	Rishikimi i manualit për planifikim strategjik për të reflektuar ndryshimet në kornizën e planifikimit strategjik	TM2 2025	1,000.00			BK	ZPS/ZKM	Manuali i miratuar dhe publikuar	Rregullorja e Punës së Qeverisë 17/2024
1.1.4	Vlerësimi i funksionimit të strukturave koordinuese për planifikim strategjik	TM3 2025	1,000.00			BK	ZPS/ZKM	Analiza dhe propozimi i finalizuar	Rregullorja e Punës së Qeverisë 17/2024
1.1.5	Rishikimi i strukturave koordinuese për planifikim strategjik	TM4 2025	1,000.00			BK	ZKM	Vendimi për strukturat e planifikimit të finalizuar	Rregullorja e Punës së Qeverisë 17/2024
1.1.6	Rishikimi dhe miratimi i programit/modulit të trajnimit për planifikim dhe menaxhim strategjik	TM4 2025	1,000.00			BK	ZPS/ZKM IKAP	Programi për planifikim dhe miratim strategjik i miratuar	Rregullorja e Punës së Qeverisë 17/2024
1.1.7	Mbajtja e trajnimeve për shërbyesit civil në nivel qendror – për planifikim dhe menaxhim strategjik	Në vazhdimësi	1,000.00	1,000.00	1,000.00	BK	IKAP	Deri në 50 zyrtarë që merren me planifikim dhe monitorim të politikave të trajnuar	N/A

1.1.8	Përgatitja e konceptit për zhvillimin e analizave paraprake (foresight analysis)	TM4 2025	5,000.0 0				ZPS/Z KM	Koncepti për zhvillimin e analizave paraprake i përgatitur	N/A
1.1.9	Rishikimi i ndërmjetëm i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, vlerësimi i zbatimit dhe rishikimi i treguesve të ndikimit	TM2 2026	5,000.0 0	10,00 0.00		BK/ Donatorë t	ZPS/Z KM Ministritë e linjës	Rishikimi i Strategjisë dhe Plani Kombëtar për Zhvillim i miratuar	SKZH 2030
1.1.10	Reflektimi i masave afatshkurtra të Programit Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) si aktivitete të PKZH për vitin 2025 gjatë rishikimit vjetor të të dy dokumenteve	Ne vazhdi mësi	0	0	0	BK	ZKM Ministritë dhe institucionet e tjera relevante	PKZH i harmonizuar me PKIE	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 (kapitulli 2.4, pjesa 2.4.1.)
1.1.11	Reflektimi i masave/hapave reformave të Agjendës së Reformave në kuadër të Instrumentit të BE-së për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor (AR) në pjesët relevante të PKZH-së (për vitet 2025-2027) gjatë rishikimit vjetor të PKZH-së	Ne vazhdi mësi	0	0	0	BK	ZKM Ministritë dhe institucionet e tjera relevante	PKZH i harmonizuar me Agjendën e Reformave	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 (kapitulli 2.4, pjesa 2.4.1.)
I.2	Objektivi specifik 2: Rritja e performancës institucionale, transparencës dhe llogaridhënies								
1	Treguesi: % e strategjive të miratuara që kanë raporte vjetore të hartuara dhe publikuara. ² Burimi: ZPS-Raporti vjetor i PVDS	40% 2024		50% 2025		95% 2027		Përmirësimi i zbatimit të dokumenteve strategjike; si dhe, Përmirësimi i transparencës publike të institucioneve Qeveritare	

² Ndërlidhur me procesin e negociimit me BE për SBS.

2	Treguesi: % e zotimeve të përgjithshme të bartura në vitet pasuese (ligjet, strategjitë dhe zotimet e IE) ³ Burimi: ZKM-Raporti vjetor	45% 2024	35% 2025			20% 2027	Përmirësimi i zbatimit të zotimeve të përgjithshme të përfshira në PSO		
Nr	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente
			Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027				
1.2.1	Përgatitja e indeksit/pasaportës së indikatorëve dhe përditësimi i vazhdueshëm i tyre	TM4-2027	10,000.00	10,000.00	10,000.00	BK	ZKM Ministrinë e Linjës	Indeksi i treguesve i përgatitur dhe publikuar	PKZH
1.2.2	Aplikimi i planeve institucionale në të gjitha nivelet ministore	TM1 2026	10,000.00	10,000.00		BK, Donatori	ZKM Ministrinë e Linjës	Të gjitha ministrinë të kanë hartuar dhe miratuar planet institucionale	PKZH
1.2.3	Zhvillimi i instruksioneve dhe formave të monitorimit dhe raportimit të Planeve Institucionale	Q1 2026		5,000.00		BK Donatori	ZKM, Ministrinë e Linjës	Instruksionet dhe format e raportimit dhe monitorimit janë zhvilluar	N/A
1.2.4	Zhvillimi i sistemit elektronik për planifikim, monitorim dhe raportim të punës së Qeverisë	TM2 2026	100,000.00 ⁴			BK, Donatori	ZKM Ministrinë e Linjës	Organizimi i PKZH-se dhe hartëzimi i të dhënave Krijimi i specifikave të të dhënave për aspektet	N/A

³ Për vitin 2021 nuk ka të dhëna për të gjitha aktivitetet e PSO. Raporti i SIGMA e vlerëson zotimet e bartura për programin legjislativ për 2020-2021 në nivel të 73% e atë të planit strategjik në 87%. Në vitin 2021, nga monitorimi i Institutit të Kosovës për Drejtësi, programi legjislativ është zbatuar në nivel të 63%. Bazuar në këto të dhëna, vlerësohet se caku për 2023 të paraqitet në nivelin e 25% të të gjitha zotimeve, përfshi programin legjislativ, agjendën evropiane, etj.

⁴ Aktiviteti është pjesë e zhvillimit të platformës së përgjithshme qeveritare (Whole of Government Platform), që financohet përmes Projektit (huasë) të Bankës Botërore për Digitalizim. Kostoja e zhvillimit të platformës mbarëqeveritare përfshinë rreth 1.000.000 euro, ndërsa në kuadër të kësaj moduli i parë që do të zhvillohet është sistemi i planifikimit dhe monitorimit, dhe pritet të ketë kosto rreth 100.000 euro.

								e monitorimit te PKZH-se	
1.2.5	Organizimi strukturor në ZKM dhe Ministri për sistemin elektronik për planifikim, monitorim dhe raportim	TM1 2026		5,000.00		BK	ZKM	Strukturat për monitorim dhe raportim të definuara	SKZH
1.2.6	Zhvillimi i dritares për Planin Kombëtar për Zhvillim 2030 në web faqen e ZKM	TM4 2025		3,000.00		BK	ZKM	Ueb faqja/portali i politikave i zhvilluar dhe lansuar	PKZH
1.2.7	Përgatitja dhe publikimi i raporteve periodike dhe vjetore të punës së Qeverisë (PKZH)	TM1 TM4 2025 Në vazhdi mësi	1,000.00	1,000.00	1,000.00	BK	ZSP-ZKM	Raportet vjetore të punës së qeverisë publikohen më së largu deri në fund të marsit të secilit vit	PKZH
1.2.8	Zhvillimi i raporteve per strategjitë sektoriale dhe publikimi i tyre	Në vazhdi mësi	1,000.00	1,000.00	1,000.00	BK	ZKM Ministritë e linjës	Raportet vjetore të strategjive publikohen në ueb faqen e ZKM dhe të ministrive më së largu deri në fund të marsit të secilit vit	Rregullorja e Punës së Qeverisë 17/2024
1.2.9	Hartimi i manualit për konsultime me publikun	TM3 2025	2,000.00	1,000.00	1,000.00	BK	ZKM/ ZQM ZKM/ ZL Dhe OJQ-të	Publikimi i Manualit për Konsultime me Publikun	Rregullorja e Punës së Qeverisë 17/2024
1.2.10	Përgatitja e modulit të trajnimit në lidhje me manualin e ri	TM4 2025		2,000.00	2,000.00	BK/Dona torët	ZKM/ ZQM	Moduli i trajnimit është zhvilluar dhe miratuar	Rregullorja 17/2024
1.2.11.	Ngritja e kapaciteteve/trajnimi i nëpunësve civilë/pikat fokale për zbatimin e manualit në nivel qendror)	TM2 2026		5,000.00	1,000.00	BK/Dona torët	ZKM/ ZQM	Janë zhvilluar dhe përmirësuar kapacitetet e zyrtarëve në institucionet	N/A

								publike për zbatimin e rregullores së re për konsultimin publik	
1.2.12	Avancimi i platformës së konsultimeve publike	TM4 2025	5,000.0 0	3,000. 00	1,000. 00	BK/Dona torët	ZKM/ ZQM, Ministr itë e linjës dhe OJQ-të	Platforma dhe avancimi i saj në përputhje me sistemet e reja dixhitale Përfshirja e raportimit të drejtpërdrejtë në platformë	PKZH
1.2.13	Trajnim për përdorimin e platformës nga institucionet	TM2 2026		3,000. 00	5,000. 00	Donors	IKAP ZKM/ ZQM,	Sesionet e trajnimit organizohen nga ZQM/ZKM	N/A
I.3.	Objektivi Specifik 3.: Zhvillimi i politikave duke u bazuar në të dhëna dhe ngritja e kapaciteteve⁵								
1	Treguesi: % e ligjeve për vit që janë në përputhje me opsionin e rekomanduar në koncept dokument. ⁶ Burimi: ZPS – Raporti i kontrollit të cilësisë së zbatimit të listës së koncept dokumenteve	65% 2024	85% 2027			Përmirësimi i politikave ligjore të planifikuara dhe bazuara në të dhëna si dhe ndërlidhja më e mirë e vlerësimeve paraprake me projektligjet pasuese.			
2	Treguesi: Numri i zyrtarëve publikë të trajnuar për (1) koncept dokumente, (2) hartim i legjislacionit, (3) vlerësim expost të legjislacionit, (4) përafrim të akteve juridike me Acquis të BE-së dhe për (5) konsolidim të akteve juridike Burimi: IKAP	1. 19 2. 0 3. 38 4. 28 5. 0 (2024)	1. >100 2. >100 3. >100 4. >100 5. >100			1. >150 2. >150 3. >150 4. >150 5. >150			Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve publikë për hartimin dhe vlerësimin e politikave publike.

⁵ Këtë objektive specifike e plotësojnë edhe veprimet përkatëse e planifikuara në Planin e Veprimit të Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2026.

⁶ Ky tregues i referohet të gjeturave dhe rekomandimeve të SIGMA (Raporti i monitorimit, 2021, fq. 28-29), mbi kontrollin e cilësisë për sigurimin se të gjeturat dhe analizat gjatë vlerësimit të ndikimit rregullator, të merren parasysh dhe të reflektohen në legjislacionin që pason si opsion i rekomanduar në koncept dokument.

3	Treguesi: Rregullimi më i mirë nëpërmjet shfuqizimit të akteve nënligjore të miratuara nga Qeveria, që nuk kanë bazë ligjore ⁷ Burimi: Vendimi i Qeverisë për shfuqizimin e akteve nënligjore të miratuara nga Qeveria të cilat nuk kanë bazë ligjore dhe procesverbali i mbledhjes së Qeverisë	0 2022	>50%			N/A	Zbatimi i listës së kontrollit për sundim të ligjit të Komisionit të Venedikut, nëpërmjet shfuqizimit të akteve nënligjore të miratuara nga Qeveria që nuk kanë bazë ligjore.		
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente
			Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027				
1.3.1	Zhvillimi dhe vendosja e metodologjisë për priorizimin e politikave /agjendën legjislative	TM2 2025	1,500.0 0			BK	ZL/ZP S/SKQ /ZKM	Metodologjia e zhvilluar	N/A
1.3.2	Rishikimi i manualit për hartimin e koncept dokumenteve	TM2 2025	5,000.0 0			Donatori	SKQ/Z KM	Udhëzuesi dhe manuali i miratuar	Rregullorja e Punës së Qeverisë 17/2024
1.3.3	Përditësimi i modulit të trajnimeve për vlerësim rregullator/koncept dokumente	TM4 2025	3,000.0 0			Donatori	SKQ/Z KM IKAP	Moduli i përditësuar	Rregullorja e Punës së Qeverisë 17/2024

⁷ Ky tregues është treguesi nr. 1, si pjesë e Marrëveshjes mbi treguesit për transhin e ri nën Kontratën për Mbështetje Buxhetore Sektoriale për Reformën e Administratës Publike, me numër IPA 2016/039474.

1.3.4	Përgatitja a trajnerëve për modulën e trajnimeve për vlerësim rregullator/koncept dokumente	TM1 2025	1,500.0 0			BK	SKQ/Z KM IKAP	Numri i trajnerëve të certifikuar	Manuali dhe udhëzuesi për vlerësim rregullator/koncept dokumente
1.3.5	Mbajtja e trajnimeve për shërbyes civil për vlerësim rregullatorë/koncept dokumente	Në vazhdi mësi	10,000. 00	10,00 0.00	10,00 0.00	BK	SKQ/Z KM IKAP	Numri i zyrtarëve të trajnuar (se paku 100 zyrtare)	Manuali dhe udhëzuesi për vlerësim rregullator/koncept dokumente
1.3.6	Finalizimi dhe Miratimi i Udhëzimit Administrativ për Standardet e Hartimit të Legjislacionit së bashku me Manualin për Hartimin e Legjislacionit dhe Manualit për Harmonizimin e Legjislacionit me Acquis të BE-se	TM1 2025	2000.0 0			BK	ZL/ZK M	Udhëzimi i ri i miratuar	Ligji Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës Ligji Nr. 04/-L-025 për Nisma Legjislative
1.3.7	TOT për hartimin e akteve juridike	TM3 2025	1,000.0 0			BK	ZL/ZK M IKAP	Trajnimet e mbajtura (5 grupe nga 15 pjesëmarrës)	N/A
1.3.8	Trajnimi i zyrtarëve ligjorë për hartimin e legjislacionit	TM4 2027 Në vazhdi mësi	5,000.0 0	5,000. 00	5,000. 00	BK	ZL/ZK M IKAP	Zyrtarët e trajnuar/ pilotimi i institucioneve dhe zyrtarëve	N/A
1.3.9	Trajnimi i zyrtarëve ligjorë për vlerësimin ex-post të legjislacionit	TM4 2027 Në vazhdi mësi	2,000.0 0	2,000. 00	2,000. 00	BK	ZL/ZK M IKAP	5 grupe nga 15 pjesëmarrës	N/A

1.3.10	Krijimi i modulit te trajnimit per përdorimin e Sistemit per Hartimin e Legjislacionit (LDS)	TM1 2025	2,000.0 0			BK	ZL/ZK M IKAP	Moduli i trajnimit për përdorimin e Sistemit për Hartimin e Legjislacionit i krijuar	Rregullorja e Punës së Qeverisë 17/2024
1.3.11	Trajnimet për zyrtarët ligjorë te departamenteve ligjore dhe zyrtareve te tjerë publike për përdorimin e sistemit të hartimit të legjislacionit	TM4 2027 Në vazhdi mësi	2,000.0 0	2,000. 00	2,000. 00	BK	ZL/ZK M IKAP	2 trajnime 2024 3-5 për çdo vit/ 15 pjesëmarrës	N/A
1.3.12	Trajnimi për trajner për harmonizim të legjislacionit me Acquis	TM4 2025	1,000.0 0			BK	ZL/ZK M IKAP	Certifikimi i trajnerëve	N/A
1.3.13	Zhvillimi i modulit për trajnim për konsolidimin e akteve juridike	TM4 2025	2,000.0 0			BK	ZPGZ/ ZKM IKAP	Moduli i zhvilluar	N/A
1.3.14	Trajnimi zyrtarëve përkatës për konsolidimin e akteve juridike	TM1 2026 Në vazhdi mësi	2,000.0 0	2,000. 00		BK/	ZPGZ/ ZKM IKAP	3-5 për çdo trajnim	N/A
1.3.15	Zhvillimi i planit për konsolidimin e legjislacionit primar të përzgjedhur	TM4 2025	2,000.0 0			Donatorë	ZPGZ/ ZKM	Plani i zhvilluar	N/A
1.3.16	Zhvillimi i planit për konsolidimin e legjislacionit dytësor të përzgjedhur	TM4 2025	2,000.0 0			Donatorë	ZPGZ/ ZKM	Plani i zhvilluar	N/A
1.3.17	Zhvillimi i platformës elektronike për konsolidimin e akteve juridike	TM4 2026		70,00 0.00		Donatorë	ZPGZ/ ZKM	Platforma e zhvilluar	N/A
1.3.18	Hartimi i Manualit për Komunikimin me Publikun	TM2 2025	2,000.0 0			Donatorë	ZQM/ ZL/ZK M	Manuali i hartuar	Rregullorja e Punës së Qeverisë 17/2024
1.3.19	Hartimi i metodologjise për kryerjen e analizës së zbatimit të ligjeve dhe Listës së Kontrollit të Zbatimit të Ligjit	Q4 2025	2,000.0 0			Donatorë	ZL/ZK M	Metodologjia e hartuar	Rregullorja e Punës së

									Qeverisë 17/2024
1.3.20	Hartimi i metodologjisë për kryerjen e analizës gjithëpërfshirëse për harmonizimin dhe pastrimin e ligjeve dhe Listës së Harmonizimit Ligjor)	Q4 2025	2,000.0 0			Donatorë	ZL/ZK M	Metodologjia e hartuar	Rregullorja e Punës së Qeverisë 17/2024
1.3.21	Kryerja e analizës gjithëpërfshirëse për zbatimin e ligjeve mbi bazën e Listës së Kontrollit të Zbatimit të Ligjit	Q4 2026	2,000.0 0			Donatorë	ZL/ZK M	Analiza e finalizuar dhe miratuar	Rregullorja e Punës së Qeverisë 17/2024
